Raporti i garës së NIVELIT C

Data: 26 Prill 2026
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës së Kosovës
Mbështetës: Ministria e Sportit dhe Rinisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporitit, dhe Kompania Liri Prizren

1. Përshkrimi

Më 26 prill 2026, Federata e Gjimnastikës së Kosovës organizoi garat e nivelit C në Gjimnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj. Gara e nivelit C është niveli fillestar dhe ka për qëllim masovizimin e gjimnastikës në vend, si dhe krijimin e mundësive për gjimnastet dhe gjimnastët e rinj të garojnë në një garë të nivelit fillestar dhe të marrin eksperiencë. Gjatë vitit 2026, për herë të parë gara e nivelit C u nda në dy kategori: C1 dhe C2. Kategoria C1 ishte e dedikuar për gjimnastet me përgatitje më të lartë dhe me ushtrime pak më të vështira, ndërsa C2 për gjimnastet fillestare me elemente më të thjeshta dhe bazike. Për të ndihmuar trajnerët dhe klubet në përgatitjen sa më të mirë të garuesve, FGJK kishte përgatitur paraprakisht direktivat dhe manualin e garës, ku ushtrimet obligative për kategorinë C1 ishin të paraqitura me skicime, ndërsa për kategorinë C2 me video demonstrime.

Në këtë garë u regjistruan gjithsej 270 garues nga 11 klube të gjimnastikës, duke shënuar rekord pjesëmarrjeje për garat tona vendore deri më tani. Nga ta, 266 ishin femra dhe 4 meshkuj.

Klubet pjesëmarrëse ishin:
Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria,
Klubi i Gjimnastikës Elita,
Klubi i Gjimnastikës Omnisport,
Klubi i Gjimnastikës Kulina,
Klubi i Gjimnastikës Skenderaj,
Klubi i Gjimnastikës Vushtrria,
Klubi i Gjimnastikës Llapi,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan,
Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Viti,
Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova,
Klubi i Gjimnastikës Gjimnastika.

Gara u zhvillua në tri disiplina për femra: parter, tra dhe kapërcime, ndërsa për meshkuj në parter dhe kapërcime.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Gjyqtaria ishte e ndarë në tri panele me këtë përbërje:

Parter: Abeliana Bregu, Qendresa Halili, Drinesa Qerimi
Tra: Doruntinë Ibrahimi, Vilëza Zeqiri, Fitore Rudari, Jara Hasolli (vrojtuese)
Kapërcime: Arlind Shaqiri, Lisa Zeqiri
Gjyqtarët një javë para garës kishin takimin e punës ku u përsëriten informatat kryesore, përdorimi i programit për vlerësim dhe ndarja e detyrave.

Rregullimi i sallës u bë një ditë para garës nga personat e angazhuar nga FGJK duke u ndihmuar nga organizatorët, ndërsa gjatë tërë ditës së garës ishin të angazhuar vullnetarë për orientimin e garuesve, mbajtjen e rendit dhe ndihmën gjatë rotacioneve.

2. Ecuria e garës.

Takimi i organizatorëve, gjyqtarëve, vullnetarëve dhe trajnerëve u mbajt në ora 08:00.
Pas fjalës hapëse gara filloi zyrtarisht në ora 09:00 me kategorinë C2 dhe vazhdoi sipas planit të punës dhe rotacioneve të përcaktuara paraprakisht. Klubet kishin listen startuese dhe planin e punës të dërguar përmes emailit.

Paradite (C2)
Nga ora 09:00 deri në ora 13:00 garuan gjimnastet e kategorisë C2 sipas grupmoshave të ndara në dy termine. Në secilën vegël, para fillimit të ushtrimeve, gjimnastet kishin kohë të mjaftueshme për nxemje. Rotacionet u zhvilluan në mënyrë të rregullt, me ndihmën e vullnetarëve të FGJK-së të cilët orientonin grupet nga një vegël në tjetrën.
Në ora 13:00 u mbajt ceremonia e ndarjes së medaljeve për kategorinë C2.

Pasdite (C1)
Nga ora 14:00 filloi gara për kategorinë C1, ku u paraqitën gjimnastet më të përgatitura me ushtrime më të vështira dhe me nivel më të lartë teknik. Edhe kjo pjesë e garës u zhvillua sipas rotacioneve të parapara në planin e punës.
Ceremonia përfundimtare e ndarjes së medaljeve u mbajt pas përfundimit të garës, ndërsa aktiviteti përfundoi në ora 18:00. Për shkak të numrit rekord të pjesëmarrësve dhe publikut të pranishëm, organizimi kërkoi koordinim të madh nga organizatorët, trajnerët, gjyqtarët dhe vullnetarët, por gara u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe me atmosferë shumë të mirë sportive.
Sipas vendimit të FGJK-së, u shpërblyen tetë vendet e para për secilën disiplinë dhe secilin vit të lindjes, duke u siguruar që secila gjimnaste të marrë të paktën një medalje gjatë garës. Për këtë aktivitet u siguruan gjithsej 600 medalje.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Orari i garave për grupmoshë dhe kategori:	
C2 **Viti i lindjes:** 2021, 2020, 2019, 2018, 2017	**Ora:** 09:00 - 11:00
C2 **Viti i lindjes:** 2016, 2015, 2014, 2013, 2012, 2011	**Ora:** 11:00 - 13:00
Pushim	**Ora:** 13**:00 - 14:00**
C1 **Viti i lindjes:** 2021, 2020, 2019, 2018, 2017	**Ora:** 14:00 - 16:00
C1 **Viti i lindjes:** 2016, 2015, 2014, 2013, 2012, 2011	**Ora:** 16:00 - 18:00

3. Përfundimi

Gara e nivelit C 2026 mund të konsiderohet një nga garat më të mëdha dhe më të suksesshme të organizuara deri më tani nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës. Ndarja e garës në kategoritë C1 dhe C2 rezultoi shumë pozitive dhe ndihmoi në përshtatjen më të mirë të nivelit të ushtrimeve sipas përgatitjes së gjimnasteve. Poashtu, përdorimi i manualit/ direktivave lehtësoi dukshëm punën e trajnerëve dhe përgatitjen e garuesve. Gara u zhvillua me disiplinë të mirë, koordinim të mirë organizativ dhe pjesëmarrje shumë të lartë të publikut. FGJK mori komente pozitive nga trajnerët dhe klubet për organizimin, strukturën e re të garës dhe nivelin e zhvillimit të aktivitetit. Rezultatet e garave janë postuar në webfaqen zyrtare të FGJK-së. FGJK falenderon partnerët: Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit, si dhe kompaninë Liri Prizren.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Disa foto nga gara:










FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION





Amir Tahiraga:_____

Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së

Data e raportit: 28.05.2026
Prishtinë